



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

---

**PROJEKT LIGJ PËR TRANSPORTIN RRUGOR**

**DRAFT LAW ON ROAD TRANSPORT**

**NACRT ZAKONA O DRUMSKOM TRANSPORTU**



<b>REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI</b>	<b>REPUBLIC OF KOSOVO ASSEMBLY</b>	<b>REPUBLIKA KOSOVO SKUPŠTINA</b>
<p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p>	<p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p>	<p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p>
<p>Miraton:</p>	<p>Approves:</p>	<p>Usvaja:</p>
<p><b>LIGJ PËR TRANSPORTIN RRUGOR</b></p>	<p><b>LAW ON ROAD TRANSPORT</b></p>	<p><b>ZAKONA O DRUMSKOM TRANSPORTU</b></p>
<p><b>KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p>	<p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p>	<p><b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b></p>
<p><b>Neni 1 Qëllimi i ligjit</b></p>	<p><b>Article 1 Purpose of Law</b></p>	<p><b>Član 1 Cilj zakona</b></p>
<p>Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese në treg, ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave si dhe rregullimin e regjimit të ngasjes dhe pushimit.</p>	<p>The purpose of the present law is to regulate and develop the sector of the road transport of passengers and goods, an open and non-discriminatory access to the market, provision of services in the market of the road transport of passengers and goods sector as well as to establish driving and resting regime.</p>	<p>Cilj ovog zakona je regulisanje i razvoj sektora drumskog transporta putnika i roba, otvoren i ne diskriminirajući pristupom na tržište, pružanje usluga na tržište drumskog sektora putnika i roba kao i regulisanje režima vožnje i odmora.</p>



<b>Neni 2</b> <b>Fusha e zbatimit</b>	<b>Article 2</b> <b>Scope of the Law</b>	<b>Član 2</b> <b>Oblast sprovođenja</b>
<p>1. Ligji rregullon kushtet e qasjes në treg te operatoreve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave që përdor të paktën një mjet motorik ose një tërësi mjetesh pesha e mjetit e të cilëve është mbi 3,5 tonë dhe jo më pak se 6 tonë pesha e ngarkesës për të kryer transportin e mallrave, ose të paktën me një automjet i cili është teknikisht në gjendje te rregullt, për nga lloji i konstruktimit dhe pajisjeve, për të transportuar më shumë se 8+1 ulëse, përfshirë edhe ngasësin për të kryer transport të udhëtarëve.</p> <p>2. Ligji rregullon kushtet e realizimit të shërbimeve të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, që kryhet nga operatorët e transportit rrugor që janë të themeluar në Kosovë e që kryejnë transport vendor ose ndërkombëtar dhe nga operatorët e transportit jorezident që kryejnë transport ndërkombëtar që kanë në destinacion Kosovën ose kalojnë tranzit.</p> <p>3. Përveç tjerash, ligji cakton kushte dhe kriteret lidhur me kohëzgjatjen e ngasjes, kohën e pushimit për drejtuesit e automjeteve</p>	<p>1. The present law regulates conditions pertaining to the access to the market of the operators of the road transport of passengers and goods, using at least one motor or a group of motor vehicles for transportation of goods, whose weight is above 3.5 tons and not less than 6 tons, or at least one motor vehicle which, as to the type of construction and equipment, is in good technical conditions, with more than 8 + 1 seats, including the driver, for the provision of transportation of passengers.</p> <p>2. The present Law regulates conditions pertaining to the services of the road transport of goods and passengers, provided by road transport operators set up in Kosovo, carrying out domestic and international transport and by non-residential transport operators carrying out international transports whose final destination is Kosovo or just passing through as transit.</p> <p>3. In addition, the present law determines conditions and criteria pertaining to the driving duration and resting duration for motor vehicle</p>	<p>1. Zakon reguliše uslove pristupa na tržište operatera drumskog transporta putnika i roba koji upotrebljava najmanje jedno motorno sredstvo ili jednu celinu sredstava čija težina prevoznog sredstva je iznad 3.5 tone i ne manje od 6 tona težine tereta za obavljanje transporta roba, ili najmanje s jednim vozilom koje je tehnički u ispravnom stanju, u pogledu vrste konstrukcije i opreme, da transportuje sa više od 8+1 sedišta, obuhvatajući i vozača, da obavlja transport putnika.</p> <p>2. Zakon reguliše uslove ostvarivanja usluga drumskog transporta roba i putnika, koje se obavljaju od operatera drumskog transporta koji su osnovani na Kosovu i koji obavljaju domaći ili međunarodni transport i od operatera nerezidentnog transporta koji obavljaju međunarodni transport i imaju za destinaciju Kosovo ili tranzitno prolaz.</p> <p>3. Između ostalog, zakon određuje uslove i kriterijume vezane s vremenskim trajanjem vožnje, vremenu odmora za vozače vozila</p>



<p>që kryejnë shërbime të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, për nevoja të veta ose të personit tjetër, si dhe modalitetet e përdorimit të tahografit.</p>	<p>drivers who are carrying out services of the road transport of goods and passengers for their own needs or other persons' needs as well as modalities regarding the use of tachograp.</p>	<p>koji obavljaju usluge drumskog prevoza roba i putnika, za njihove potrebe ili druga lica, kao i modaliteta upotrebe tahografa.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Përkufizimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Definitions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Definicije</b></p>
<p>1. Shprehjet e përdora në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. “Ministria” nënkupton Ministrinë përkatëse për transport;</p> <p>1.2. “Komunë” nënkupton njësinë themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale;</p> <p>1.3. “Rrugë publike” nënkupton një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;</p> <p>1.4. ”Operator-taksi” nënkupton veprimtarinë e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe</p>	<p>1. Terms used in the present law have the following meaning:</p> <p>1.1. "Ministry" means the relevant Ministry of Transport;</p> <p>1.2. “Municipality” means the basic territorial unit of the self-government in Kosovo defined by the relevant Law on Self-Government;</p> <p>1.3. "Public Road" means a surface of general importance for the traffic where everyone can move under the conditions set by law, and that the competent authority has announced as a public road;</p> <p>1.4. ”Taxi-Operator” means the activity of passengers’ transport exercised by physical and juridical persons;</p>	<p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju ova značenja:</p> <p>1.1. “Ministarstvo” je ministarstvo nadležno za promet;</p> <p>1.2. “Opština” podrazumeva osnovnu teritorijalnu jedinicu na Kosovu, utvrđenu prema Zakonu o lokalnoj samoupravi;</p> <p>1.3. “Javni put” je površina od opšteg interesa za promet kojom se mogu kretati vako shodno uslovima propisnaim zakonor i koji je nadležno organ proglasio javnim putem;</p> <p>1.4. ”Operater-taksi” podrazumeva delatnost transporta putnika koji se vrši od fizičkih ili pravnih lica;</p>



<p>juridik;</p> <p>1.5. “Stacion i autobusëve” nënkupton objektin me infrastrukturën përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve dhe udhëtarët;</p> <p>1.6. ”Vend-ndalje ” nënkupton sipërfaqen e ndërtuar dhe të shënjuar posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve;</p> <p>1.7. “Transport bilateral” nënkupton transportin e udhëtarëve ose të mallrave ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera;</p> <p>1.8. “Itinerar” nënkupton aktin i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;</p> <p>1.9. “Lëshues i licencës” nënkupton organin i cili sipas dispozitave të këtij ligji është kompetent për lëshimin e licencës;</p> <p>1.10. “Certifikatë e automjetit” nënkupton</p>	<p>1.5. “Bus station” means the premises and associated infrastructure licensed by Ministry for the purpose of providing services to the road passenger transport operators and passengers;</p> <p>1.6. ”Bus stop ” means a constructed and particularly marked surface designated for buses to stop and to allow a safe embarking and disembarking of passengers and luggage;</p> <p>1.7. “Bilateral transport” means transport of passengers and goods between Kosovo and other countries;</p> <p>1.8. “Itinerary” means an act which determines the direction of the movement of vehicles in the line;</p> <p>1.9. “License issuer” means the authority, which in accordance with the provisions of present law is competent to issue the licence;</p> <p>1.10. “Vehicle certificate” means the</p>	<p>1.5. “Autobuska stanica” podrazumeva objekat s pratećom licenciranom infrastrukturuom od Ministarstva radi pružanja usluga operatorima drumskog prevoza putnika i roba;</p> <p>1.6. Stajalište ” podrazumeva posebno izgrađenu i zabeleženu površinu, određenu za stajanje autobusa koja omogućava sigurno ukrcavanje i uskrcavanje putnika i prtljaga;</p> <p>1.7. “Bilateralni transport” podrazumeva transport putnika i roba između Kosovo i drugih država;</p> <p>1.8. “Itinerar” podrazumeva akt koji utvrđuje pravac kretanja vozila na linijama;</p> <p>1.9. “Izdavalac licence” podrazumeva organ koji prema zakonu je nadležan za izdavanje licence;</p> <p>1.10. “Uverenje vozila” podrazumeva</p>
---	--	--



<p>dokumentin të cilin e lëshon organi kompetent për çdo automjet veç e veç dhe i cili përmban të dhënat për: lëshuesin e organit kompetent, operatorin e transportit, numrin e licencës, përkatësisht lejes, shenjën (targat) e regjistrimit, markën tipin, numrin e shasisë së automjetit, kapacitetin bartës, llojin e transportit që mund të kryhet, datën e lëshimit të certifikatës, vulën dhe nënshkrimin;</p> <p>1.11. “Operator i transportit rrugor të mallrave” nënkupton veprimtarinë e çdo operatori transportues të mallrave që kryen transport për nevoja personale dhe palë të tretë, me anë të mjeteve motorike ose të mjeteve të kombinuara;</p> <p>1.12. “Operator i transportit rrugor të udhëtareve” nënkupton veprimtarinë e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e më shumë se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin, dhe të destinuara për këtë qëllim, shërbimet e transportit të pasagjerëve për publik ose për kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga</p>	<p>document issued by the competent authority for each vehicle separately containing the following data: competent issuing authority, transport operator, the number of the license, respectively of the permit, license plates, type, vehicle chassis number, carrying capacity, type of transport which may be carried out, issuing date of the certificate, the stamp and signature;</p> <p>1.11. “Operator of the road transport of goods” means the activity of each operator of the road transport of goods, carrying out transports on their own account or on the account of third parties, through the usage of motor vehicles or other combined assets;</p> <p>1.12. “Operator of the road transport of passengers” means the activity of each operator, operating by means of motor vehicles suitable for transportation of more than nine persons, including the driver, designated for this purpose, for services of transportation of passengers in public or for particular categories of users in exchange of a payment by transported person or by transport organizer;</p>	<p>dokument koji izdaje nadležni organ za svako vozilo posebno i koje sadrži podatke za: izdavaoca nadležnog organa, operatera transporta, broj licence, odnosno dozvole, registrarske oznake (tablice), marku, tip, broj šasije vozila, kapacitet nosivosti, vrstu transporta koji se može obavljati, datum izdavanja uverenja, pečat i potpis;</p> <p>1.11. “operater drumskog transporta roba” podrazumeva delatnost svakog transportnog operatera roba koji obavlja transpor za sopstvene potrebe i treća lica, putem motronih sredstava ili kombinovanih prevoznih sredstava;</p> <p>1.12. “Operater drumskog transporta putnika” podrazumeva delatnost svakog operatera koji deluje putem motornih sredstava koja su podobna za transport više od devet osoba, obuhvatajući i vozača, i namenjenih za ovu svrhu, usluge trasporta putnika za javnost ili za posebne kategorije korisnika u razmeni plaćanja od transportovanog lica ili od organizatora transporta;</p>
--	--	---



<p>organizatori transportit;</p> <p>1.13. “Menaxher transporti” nënkupton një person fizik i cili posedon certifikatën e kompetencës profesionale për menaxher (CPC) i punësuar nga një operator i transportit rrugor me anë të një kontrate, të cilët në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme menaxhon aktivitetet e transportit të atij operatori;</p> <p>1.14. ”Shërbim i rregullt special” do të thotë shërbim i rregullt të organizuar, i cili ofron bartje të një kategorie të caktuar udhëtarësh duke përjashtuar udhëtarët e tjerë;</p> <p>1.15. “Transport publik” nënkupton transportin të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit;</p> <p>1.16. “Transport publik linjor i udhëtarëve” nënkupton transportin i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht;</p>	<p>1.13. “Transport manager” means the physical person holding the Certificate of Professional Competence for manager (CPC) employed by an operator of the road transport by means of a contract, who effectively and continuously manages operator’s transport activities;</p> <p>1.14. ”Regular special service” means the regular and organized service, providing the transportation of a certain category of passengers, excluding other passengers;</p> <p>1.15. “Public transport” means the transport which under equal conditions is suitable to all users of transport services;</p> <p>1.16. “Regular public transport of passengers” means the transport performed on given routes and timetable, prices, terms and under previously laid down conditions;</p>	<p>1.13. “Menadžer transporta” podrazumeva jedno fizičko lice koje poseduje uverenje stručne nadležnosti za menadžera (UPN) zaposlen od jednog operatera drumsog transporta putem jednog ugovora, koji efektivno i stalno menaduje aktivnosti transporta tog operatera;</p> <p>1.14. ”Specijalna redovna usluga” znači redovnu organizovanu uslugu, koju pruža prevoz jedne određene kategorije putnika isključujući druge putnike;</p> <p>1.15. “Javni transport” podrazumeva transport koji pod jednakim uslovima mogu da koriste svi korisnici usluga transporta;</p> <p>1.16. “Javni linijski transport putnika” podrazumeva transport koji se vrši na određenim linijama i prema redu vožnje, cena i prethodnih utvrđenih uslova transporta;</p>
---	--	---



<p>1.17. “Kabotazh” nënkupton secilin transport të udhëtarëve ose të mallrave që kryhet në territorin e Kosovës ndërmjet pikave të veçanta të cilin e kryen operatori transportues jorezident;</p> <p>1.18. “Licencë” nënkupton aktin me të cilin operatori i transportit rrugor lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave, stacionet e autobusëve dhe terminaleve të mallrave;</p> <p>1.19. “Leje e transportit” nënkupton aktin e caktuar me këtë ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare në bazë të cilës kryhet transporti rrugor i udhëtarëve ose i mallrave;</p> <p>1.20. “Leje (CEMT)” nënkupton lejen multilaterale për kryerjen e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave në territorin e shteteve anëtare të CEMT-it, me automjetet e regjistruara në një nga shtetet anëtare të CEMT-it;</p> <p>1.21. “(CEMT)” nënkupton konferencën Evropiane e Ministrave të Transportit;</p>	<p>1.17. “Cabotage” means each transport of passengers or of goods performed within Kosovo territory between specific points performed by a non-resident transport operator;</p> <p>1.18. “License” means the act by which the road transport operator is allowed to exercise the activity of the road transport of passengers or of goods, bus stations and terminals of goods;</p> <p>1.19. “Transport permit” means the act provided for by present law or by international agreement based on which the road transport of passengers or of goods is performed;</p> <p>1.20. “Permit (CEMT)” means the multilateral permit for the performance of international road transportation of goods throughout the territory of CEMT member states, by using motor vehicles registered in one of the CEMT member status;</p> <p>1.21. “(CEMT)” means European Conference of Ministers of Transport;</p>	<p>1.17. “Kabotaž” podrazumeva svaki transport putnika ili robe koji se obavlja na teritoriji Kosovo između posebnih tačaka koje vrši nerezidentni transportni operator;</p> <p>1.18. “Licenca” podrazumeva akt s kojim operater drumskog transporta dozvoljava da se obavlja delatnost drumskog transporta putnika i roba, auktoBUSke stanice i terminali roba;</p> <p>1.19. “Dozvola transporta” podrazumeva određeni akt u ovom zakonu ili međunarodnom sporazumu na osnovu kojeg se obavlja drumski transport putnika i roba;</p> <p>1.20. “Dozvola (CEMT)” podrazumeva multeralnu dozvolu za izvršenje međunarodnog drumskog transporta roba na teritoriji država članica CEMT-ta, sa registrovanim vozilima u jednu od država članica CEMT-ta;</p> <p>1.21. „(CEMT)“ podrazumeva Evropsku Konferenciju Ministara Transporta;</p>
---	---	--





<p>1.22. “Linjë” nënkupton relacionin ose tërësinë e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;</p> <p>1.23. “Linjë ndër-urbane” nënkupton linjën e cila zhvillohet në rrugët publike magjistrale dhe regjionale të Kosovës dhe që lidhë dy apo më shumë Komuna;</p> <p>1.24. “Linjë ndërkombëtare” nënkupton linjën e cila stacionin fillestar e ka në territorin e Kosovës ndërsa atë përfundimtar jashtë territorit të Kosovës”;</p> <p>1.25. “Linjë urbane” nënkupton linjën e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune;</p> <p>1.26. “Linjë urbane-periferike” nënkupton linjën e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit të</p>	<p>1.22. “Line” means the route or collection of routes for the performance of transport in the road traffic, starting from the initial station (departure point) to the final station respectively destination, where passengers are to be transported according to the registered and published timetable with one or more departures;</p> <p>1.23. “Interurban lines” means the itinerary taking place in Kosovo public highways and regional roads connecting two or more Municipalities;</p> <p>1.24. “International line” means the route (line) with the initial station (departure point) within Kosovo territory and final destination outside of Kosovo territory;</p> <p>1.25. “Urban line” means the route (line) connecting two or more stations, respectively bus stops within urban borders of a Municipality;</p> <p>1.26. “Urban- suburban line” means the line connecting two or more stations, respectively stops within the territory of a</p>	<p>1.22. “Linija” podrazumeva relaciju ili celinu relacija izvršenja transporta u drumskom transportu, od početne do krajnje stanice, odnosno na krajnjem mestu stajanja, u kome se transportuju putnici prema registrovanom i objavljenom redu vožnje s jednim ili više polazaka;</p> <p>1.23. “Međugradska linija” podrazumeva liniju koja se odvija u javnim magistralnim i regionalnim putevima Kosovo koja povezuje jednu ili više opština;</p> <p>1.24. “Međunarodne linije” podrazumeva liniju koja početnu stanicu ima na teritoriji Kosovo, dok krajnu van teritorije Kosovo”;</p> <p>1.25. “Gradska linija” podrazumeva liniju koja povezuje dve ili više stanice, odnosno mesta stajanja unutar gradskih granica jedne opštine;</p> <p>1.26. “Gradsko-periferna linija” podrazumeva liniju koja povezuje dve ili više stanice, odnosno stajališta na</p>
--	--	---



<p>një Komune;</p> <p>1.27. “Linjë udhëtarësh” nënkupton linjën në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve me ndalje të obligueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit;</p> <p>1.28. “Linjë direkt” nënkupton linjën në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljes së autobusëve, e përcaktuar në rend të udhëtimit pa u ndalur nëpër vend ndalje përgjatë rrugës;</p> <p>1.29. “Linjë ekspres” nënkupton linjën në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve të përcaktuara në rend të udhëtimit duke u ndalur edhe në ndonjë stacion të rëndësishëm të autobusëve, përkatësisht në vend ndalje të autobusëve të përcaktuara në rend të udhëtimit;</p> <p>1.30. “Transport linjor ndër-urban”</p>	<p>Municipality;</p> <p>1.27. “Passengers’ Line” means the route of transportation being performed between the initial and final station, respectively between mandatory bus stops throughout all stations, actually bus stops along the route designated in the timetable;</p> <p>1.28. “Direct line” means the route of transportation being performed between initial and final bus station, respectively bus stops designated in the timetable without stopping at the bus stops along the route;</p> <p>1.29. “Express Line” means the route of transportation being performed between the initial station and final bus station, respectively bus stops designated in the timetable, with stops in some other important bus stations actually bus stops designated in the timetable;</p> <p>1.30. “Interurban transport line” means</p>	<p>teritoriji jedne opštine;</p> <p>1.27. “Linija putnika” podrazumeva liniju na kojoj se obavlja transport između polazne i krajnje stanice, odnosno autobuskog stajališta s obavezanim iskrcavanjem na svim stanicama, odnosno autobuskim stajalištima tokom utvrđenog puta u redu vožnje;</p> <p>1.28. “Direktna linija” podrazumeva liniju u kojoj se obavlja transport između polazne autobuske stanice, odnosno autobuskog stajališta, utvrđen u redu vožnje bez zaustavljanja na mestima stajanja tokom puta;</p> <p>1.29. “Ekspres linija” podrazumeva liniju u kojoj se obavlja transport između polazne i krajnje autobuske stanice, odnosno autobuskog stajališta utvrđen u redu vožnje zaustavljajući i na nekoj važnoj autobuskoj stanici, odnosno na mestima stajanja u redu vožnje;</p> <p>1.30. “Međugradski linijski transport”</p>
---	---	--



<p>nënkupton transportin publik të udhëtarëve ndërmjet dy ose më tepër komunave, kurse mund të kryhet si transport linjor i udhëtarëve, ekspres ose direkt;</p> <p>1.31. “Marrëveshje ndërkombëtare” nënkupton çdo marrëveshje bilaterale ose multilaterale e cila e obligon Kosovën dhe e cila ka të bëjë me transportet në komunikacionin rrugor;</p> <p>1.32. “Transport në linja ndërkombëtare” nënkupton transportin publik rrugor të udhëtarëve ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera;</p> <p>1.33. “Udhëtar” nënkupton personin / personat fizik të cilët transporton nga operatorët e transportit rrugor me kompensim dhe i cili në bazë të kontratës ka të drejtë transporti;</p> <p>1.34. “Transport i veçantë linjor” nënkupton transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositësit të transportit, me ç’rast transportin e paguan porositësi;</p>	<p>public transport of passengers between two or more Municipalities, which may be performed as line, express or direct transport;</p> <p>1.31. “International agreement” means each bilateral or multilateral agreement that is mandatory to Kosovo, and is related to road traffic transport;</p> <p>1.32. “International line transport” means public road transport of passengers and goods between Kosovo and other countries;</p> <p>1.33. “Passenger” means physical person that is transported by road traffic operators for a compensation, who based on contract has right to be transported;</p> <p>1.34. “Special transportation line” means transportation of a certain number of passengers which is carried out on basis of a written contract between the transport operator and the transport requestor, where transport is paid by the requestor;</p>	<p>podrazumeva javni transport putnika između dve ili više opština, a može da se obavi kao linijski transport putnika, ekspres ili direktno;</p> <p>1.31. “Međunarodni sporazumi” podrazumeva svaki bilateralni ili multilateralni sporazum koji obavezuje Kosovo i koji se odnosi na transport u drumskom saobraćaju;</p> <p>1.32. “Transport u međunrodnim linijama” podrazumeva javni drumski transport putnika između Kosovo i drugih država;</p> <p>1.33. “Putnici” podrazumeva fizičko lice/osobe koje se transportuju od operatera drumskog transporta uz naknadu i koji na osnovu ugovora ima pravo transporta;</p> <p>1.34. “Posebni linijski transport” podrazumeva transport samo jednog određenog broja putnika koji se obavlja na osnovu pismenog ugovora između operatera transporta i naručioca, kojom prilikom transport plaća naručilac;</p>
---	---	---



<p>1.35. “Transport në komunikacionin rrugor” nënkupton çdo transport të udhëtarëve ose të mallrave, duke përfshirë edhe ngasjen e automjetit të zbrazët ose të pangarkuar;</p> <p>1.36. “Transport në komunikacionin e brendshëm rrugor” nënkupton transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave brenda territorit të Kosovës;</p> <p>1.37. “Transport në komunikacionin ndërkombëtar rrugor” nënkupton transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy ose më shumë shteteve;</p> <p>1.38. “Transport nga ose për shtetet e treta” nënkupton transportin rrugor të mallrave ose të udhëtarëve të cilin e kryen operatori i transportit i cili nuk ka selinë/vendqëndrimin në shtetin në të cilin e fillon, përkatësisht e përfundon transportin;</p> <p>1.39. “Transport i lirë i rastit i udhëtarëve në komunikacionin rrugor” nënkupton transportin me të cilin një grup</p>	<p>1.35. “Transport in the road traffic” means each transport of passengers or of goods, including the driving of empty or unloaded motor vehicles;</p> <p>1.36. “Transport in the domestic road traffic” means the road traffic transport of passengers and of vehicles within the territory of Kosovo;</p> <p>1.37. “Transport in the international road traffic” means the road traffic transport of passengers and of goods between two or more status;</p> <p>1.38. “Transport from or to the third countries” means road traffic transport of goods and of passengers performed by a transport operator, which has no office /residence in the state where it initiates or finishes the transportation;</p> <p>1.39. “Free casual transport of passengers in the road traffic” means the transport by which a previously designated group of</p>	<p>1.35. “Transport u drumskom saobraćaju” podrazumeva svaki transport putnika ili roba, obuhvatajući i upravljanje praznog ili neutovarenog vozita;</p> <p>1.36. “Transport u unutrašnjem drumskom saobraćaju” podrazumeva drumski transport putnika i roba unutar teritorije Kosovo;</p> <p>1.37. “Transport u međunaraodnom drumskom saobraćaju” podrazueva drumski transport putnika i roba između dve ili više država;</p> <p>1.38. “Transport od ili za druge države” podrazumeva drumski transport roba ili putnika koje obavlja operater transporta koji nema sedište/mesto boravka u državi u kojoj počinje, odnosno završava transport;</p> <p>1.39. “Slobodni slučajni transport putnika u drumskom saobraćaju” podrazumeva transport s kojim jedna grupa prethodno</p>
--	--	--



<p>paraprakisht i caktuar i udhëtarëve transportohet sipas kushteve që janë dakorduar me kontratën ndërmjet operatorit të transportit dhe porositësit të transportit e i cili nuk është transport linjor publik, transport i veçantë linjor, transport i lirë i kohëpaskohshëm;</p> <p>1.40. “Transport i lirë vajtje-ardhje udhëtarëve në komunikacionin rrugor” nënkupton transportin me anë të cilit, me një varg udhëtimesh të nisjes dhe të kthimit grupet e udhëtarëve të formuara paraprakisht transportohen nga e njëjta vendnisje deri në të njëjtin vend të destinacionit. Secili grup i cili ka kryer udhëtimin në nisje, kthehet në vend nisje me të njëjtën ose me udhëtimet e mëvonshme të të njëjtit operator të transportit;</p> <p>1.41. “Transport për nevoja vetanake” nënkupton transportin e personave ose të mallrave të cilin e kryejnë pa kompensim personat fizikë ose juridikë, për t’i plotësuar nevojat e prodhimit ose të shërbimeve në kuadër të veprimtarive të veta;</p>	<p>passengers is transported in accordance with the conditions agreed upon by a contract established between the transport operator and the transport requestor, which is not a public transport line, special transport line or free casual transport;</p> <p>1.40. “Freedeparture–arrival transportation of passengers in the road traffic” means transportation by which groups of previously designated passengers are transported through a range of departures and returns from the same departure point to the same destination. Each group which completes the trip shall return to the departure post with the same or with latter trips provided by the same transport operator;</p> <p>1.41. “Own account transport” means the transport of passengers or of goods performed without compensation by physical or juridical persons, in order to meet the needs of production or of services within the frame of their activities;</p>	<p>određenih putnika se transportuje prema uslovima koji su namenjeni ugovorom između transportnog operatera i naručioca transporta koji nije posebno javni linijski transport, slobodan i povremen;</p> <p>1.40. “Slobodan transport za polazak-dolazak u drumskom saobraćaju” podrazumeva transport putem kojeg, u jednom nizu putovanja polaska i povratka grupe prethodno formiranih putnika se transportuju s istog mesta polaska do istog mesta destinacije. Svaka grupa koja je završila putovanje u polasku, vraća se na mestu polaska s istim ili kasnijim putovanjima istog transportnog operatera;</p> <p>1.41. “Transport za sopstvene potrebe” podrazumeva transport lica ili roba koji obavljaju bez naknade fizička ili pravna lica, radi ispunjenja potreba proizvodnje ili usluga u okviru svojih delatnosti;</p>
--	--	--



<p>1.42. “Transport për palë të tretë” nënkupton transportin e mallrave me automjet transportues apo tërësi të mjeteve të transportit të kryer me qëllime komerciale për personat tjerë fizik dhe juridik;</p> <p>1.43. “Operator i Transportit” nënkupton personin fizik ose juridik, vendor ose të jashtëm i cili posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së transportit në komunikacionin rrugor;</p> <p>1.44. “Fletudhëtim” nënkupton formularin e përcaktuar të cilin operatori i transportit duhet ta ketë gjatë kryerjes së transportit rrugor të lirë të udhëtarëve në transportin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar;</p> <p>1.45. “Fleturdhëresë e rrugës” nënkupton formularin e përcaktuar i cili përmban numrin e regjistrimit të autobusit me të cilin kryhet transporti linjor i udhëtarëve, emërtimin e linjës, kohën e fillimit dhe të mbarimit të udhëtimit, të dhënat për personelin e automjetit dhe drejtimin e qarkullimit të tij, nënshkrimin e personit të autorizuar për lëshimin e fletëurdhëresës</p>	<p>1.42. “Transport for third parties” means the transport of goods by a transporting motor vehicle or a collection of motor vehicles performed for commercial purposes for other physical and juridical persons;</p> <p>1.43. “Transport operator” means the physical or juridical person, local or international, which owns the license for the performance of activities of transport in the road traffic;</p> <p>1.44. “Waybill” means the designated form which must be in possession of the transport operator during the performance of the free road transportation of passengers in the national and in the international transport;</p> <p>1.45. “Routing order sheet” means the designated form containing the registration number of the bus by which line transport of passengers is performed, the name of the line, departure and arriving time of the trip, data pertaining to the personnel of the motor vehicle and direction of the course, signature of the person authorized to issue the routing order sheet as well as the</p>	<p>1.42. “Transport za treću stranu” podrazumeva transport roba s transportnim vozilom ili celokupnim transportnim sredstvima izvršenih s komercijalnom namerom za druga fizička i pravna lica;</p> <p>1.43. “Operater Transporta” podrazumeva fizičko ili pravno lice, domaće ili strano koji poseduje licencu za obavljanje delatnosti transporta u drumskom saobraćaju;</p> <p>1.44. “Putni list” podrazumeva utvrđeni formular kojeg operater transporta treba da poseduje tokom obavljanja slobodnog drumskog transporta putnika u unutrašnjem i međunarodnom transportu;</p> <p>1.45. “Putni nalog” podrazumeva utvrđeni formular koji sadrži registarski broj autobusa sa kojim se obavlja linijski transport putnika, naziv linije, vreme polaska i završetka putovanja, podatke za osoblje autobusa i pravac njegovg kretanja, potpis ovlašćenog lica za izdavanje putnog naloga kao i rubriku za obeležavanje prispelosti i polaska s</p>
--	--	---



<p>së rrugës si dhe rubrikën për shënimin e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve ose nga vend ndalja e autobusëve në transportin linjor;</p> <p>1.46. “Relacion” nënkupton distancën ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve;</p> <p>1.47. “Tërësi e mjeteve të transportit” nënkupton kombinimin e një mjeti tërheqës edhe të paktën një rimorkio ose gjysmë rimorkio;</p> <p>1.48. “Operator transportues i vendit” nënkupton personin fizik ose juridik me seli/vendqëndrim në Kosovë i cili posedon licencën për kryerjen e transportit ose kryen transport për nevoja vetanake në përputhje me këtë ligj;</p> <p>1.49. “Operator transportues i jashtëm” nënkupton personin fizik ose juridik i cili posedon licencën e shtetit të vet për kryerjen e transportit të udhëtarëve ose të mallrave ose i cili kryen transportin për</p>	<p>column where the arrival and departure from the bus station or from the bus stop in the transport line is to be indicated;</p> <p>1.46. “Route” means the distance between two places of the lines, which in the timetable are indicated as bus stations, respectively bus stops;</p> <p>1.47. “Overall transport vehicles” means the combination of a towing vehicle and of at least one trailer or semi-trailer;</p> <p>1.48. “Domestic transport operator” means the physical or juridical person with its headquarter/residence in Kosovo, which owns the license for the performance of transports, or performs own account transports in compliance with the present law;</p> <p>1.49. “External transport operator” means the physical or juridical person that owns the license issued by the country of its origin for transportation of passengers’ or of goods or the physical or juridical person</p>	<p>autobuske stanice ili s autobuskog stajališta u linijskom transportu;</p> <p>1.46. “Relacija” podrazumeva udaljenost između dve mesne linije koje su u redosledu putovanja zabeležene kao autobuske stanice, odnosno kao autobuska stajališta;</p> <p>1.47. “Celokupnost transportnih sredstava” podrazumeva kombinaciju jednog vučnog sredstva i najmanje jedne prikolice ili polu- prikolice;</p> <p>1.48. “Domaći transportni operater” podrazumeva fizičko ili pravno lice sa sedištem/mesnim boravkom na Kosovu koji poseduje licencu za obavljanje transporta ili obavlja transport za sopstvene potrebe saglasno s ovim zakonor;</p> <p>1.49. “Strani transportni operater” podrazumeva fizičko ili pravno lice koje poseduje licencu svoje države za obavljanje transporta putnika ili roba ili koji obavlja tranporst za sopstvsene</p>
---	--	---



<p>nevoja vetanake, kurse selinë/vendqëndrimin e ka në shtetin tjetër;</p> <p>1.50. “Terminali i mallrave” nënkupton objektin me sipërfaqe përcjellëse i licencuar nga Ministria që të ofrojë shërbime për pranimin dhe përcjelljen e automjeteve transportuese të operatorëve transportues;</p> <p>1.51. “Fletëngarkesë” nënkupton aktin i cili shoqëron mallin dhe duhet të përmbajë: datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e dërguesit, pastaj adresën e tij, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e operatorit të transportit, shenjën e regjistrimit të automjetit, datën dhe vendin e ngarkimit të mallit, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e marrësit dhe vendin e shkarkimit, shënimin e sasisë dhe të llojit të ngarkesës, listën e dokumenteve që i bashkëngjiten fletëngarkesës, shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e tjera;</p> <p>1.52. “Transport tranzit” nënkupton transportin e udhëtarëve ose të mallrave nëpër territorin e Republikës së Kosovës</p>	<p>that performs own account transports, whereas its headquarter/residence is based in another country;</p> <p>1.50. “Terminal of goods” means the building along with other additional facilities licensed by the Ministry to provide services pertaining to the reception and dispatching transport vehicles of the transport operators;</p> <p>1.51. “Consignment note” means the act accompanying goods, which should contain: the date and place of issuance, name and last name or naming of the sender, then its address, name and last name or the naming of the transport operator, motor vehicle registration sign, date and place of goods freight, name and last name or the naming of the recipient, unloading site, amount and type of load, the list of documents attached to the consignment note, transport expenditures as well as other expenditures;</p> <p>1.52. “Transit transport” means the transport of passengers or of goods throughout the territory of the Republic of</p>	<p>potrebe, dok sedište/mesto stalnog boravka ima u drugu državu;</p> <p>1.50. “Terminal roba” podrazumeva objekat s pratećom površinom licenciran od Ministarstva da pruža usluge za prijem i ispraćaj transportnih vozila transportnih operatera;</p> <p>1.51. “Tovarni list” podrazumeva akt koji združuje robu i treba da sadrži: datum i mesto izdavanja, ime i prezime ili naziv dostavljača, zatim njegovu adresu, ime i prezime ili naziv transportnog operatera, registarsku oznaku vozila, datum i mesto utovara robe, ime i prezime ili naziv primaoca i mesto istovara, obeležavanje količine i vrste utovara, listu dokumenata koji se prilažu tovarnom listu, troškove transporta i druge trokove;</p> <p>1.52. “Tranzitni transport” podrazumeva transport putnika ili robe preko teritorije Republike Kosovo bez ukrcavanja ili</p>
---	---	---





<p>pa hyrjen ose daljen e udhëtarëve, përkatësisht pa ngarkuar ose shkarkuar mallrat në Kosovë;</p> <p>1.53. “Shofer” nënkupton personin që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e automjetit transportues dhe i cili posedon certifikatën e kompetencës profesionale për shofer (CPC);</p> <p>1.54. “Rendi i udhëtimit” nënkupton aktin i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vendaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vendndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën brenda të cilës mbahet linja dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit;</p> <p>1.55. “Tarifë” nënkupton aktin i cili përmban çmimin lidhur me kryerjen e shërbimeve dhe kushteve tjera transportuese;</p>	<p>Kosovo without embarking or disembarking of passengers, respectively without loading or unloading of goods in Kosovo;</p> <p>1.53. “Driver” means the person who has gained the necessary level of qualification for driving transport vehicles and who owns the Certificate of Professional Competence (CPC);</p> <p>1.54. “Timetable” means the act which contains: the naming of the transport operator, the line where transport is to be performed, the type of line, bus stations, respectively bus stops order, then the distance from the departure site, the arrival and departure time from the bus station, respectively from the bus stops, line maintenance regime, the period within which the line is to be maintained and the validity time of the timetable;</p> <p>1.55. “Tariff” means the act containing the price pertaining to the provision of services and other transport conditions;</p>	<p>iskrcavanja putnika, odnosno utovara ili istovara robe na Kosovu;</p> <p>1.53. “Vozač” podrazumeva lice koja je stekla potrebni stepen kvalifikacije za upravljanje transportno vozilo i koje poseduje uverenje stručne nadležnosti za vozača (CPC);</p> <p>1.54. “Red vožnje” podrazumeva akt koji sadrži: naziv transportnog operatera, liniju na kojoj se vrši transport, vrsta linije, redosled autobuskih stanica, odnosno mesta autobuskih stajališta, zatim udaljenost mesta gde polazi linija, vreme dolaska i polaska iz autobuske stanice, režim održavanja linije, period u okviru kojeg se održava linija i rok važnosti reda putovanja;</p> <p>1.55. “Tarifa” podrazumeva akt koji sadrži cenu vezano s obavljanjem usluga i drugih transpornih uslova;</p>
--	---	---



<p>1.56. “Automjet i marrur me qira” nënkupton çdo mjet rrugor , i cili me pagesë dhe një periudhë të caktuar kohe mbahet nga një operator i transportit të cilin e përdorë për transport të udhëtarëve ose mallrave, duke pasur një kontratë qiraje me pronarin e automjetit;</p> <p>1.57. “CMR” nënkupton aktin që e shoqëron mallin në transportin rrugor ndërkombëtar;</p> <p>1.58. “Anëtar i ekuipazhit” është vozitësi, kondukteri dhe çdo person që e shoqëron shoferin duke marrë në mënyrë të zakonshme një pjesë efektive të operacioneve të transportit;</p> <p>1.59. “Java” është periudha ne mes orës 00:00 te Hënë dhe 24:00 te Dielën;</p> <p>1.60. “Pushimi” është çdo periudhe e pandërprerë gjate se cilës vozitësi përdor kohën e lire sipas dëshirës;</p> <p>1.61. “Ndërprerja” është çdo periudhe gjate se cilës vozitësi nuk ka drejte</p>	<p>1.56. “Rented motor vehicles” means any road traffic vehicle, which is used with pay and for a certain period of time by a traffic operator for the transportation of passengers or of goods, by having a lease with the owner of the motor vehicle;</p> <p>1.57. “CMR” means the act accompanying goods in the international road traffic transport;</p> <p>1.58. “Crew member” is the driver, ticket seller and any other person accompanying the driver who usually takes an effective part of transport operations;</p> <p>1.59. ”Week” is the period between Monday 00:00 and Sunday 24:00;</p> <p>1.60. “Resting” is any uninterrupted period during which the driver uses the leisure time as desired;</p> <p>1.61. “Break” is any period during which the driver is not allowed to drive or carry</p>	<p>1.56. “Vozilo uzeto pod zakup” podrazumeva svako drumsko transportno sredstvo, koje uz plaćanje na jedan određen vremenski period se zadržava od jednog transportnog operatera koji upotrebljava za transportovanje putnika ili roba, imajući jedan ugovor o zakupu s vlasnikom vozita;</p> <p>1.57. “CMR” podrazumeva akt s kojim se združuje roba u međunarodnom transportnom saobraćaju;</p> <p>1.58. “Član ekipe” je vozač, kondukter i svako lice koje druži vozača uzimajući na običajen način jedan efektivni deo operacija transporta;</p> <p>1.59. “Sedmica” je period između 00:00 časova Ponedjeljkom i 24:00 časa Nedeljom;</p> <p>1.60. “Odmor” je svaki neprekidni period tokom kojeg vozač upotrebljava slobodno vreme prema želji;</p> <p>1.61. “Prekid” je svaki period tokom kojeg vozač nema pravo vožnje ili</p>
--	--	---



<p>voztijeje apo kryerje te ndonjë detyre tjetër ,e qe i lejon vetëm pushim;</p> <p>1.62. “Koha pushimit ditor” është pjesa e ditës gjate se cilës vozitësi mund te kaloj kohen e lire sipas dëshirës dhe e cila mund te jete ‘pushim ditor normal’ apo ‘pushim ditor i reduktuar;</p> <p>1.63. “Kohëzgjatja e drejtimit të automjetit” është kohëzgjatja e ngasjes të ekuipazhit , gjendja në të cilën gjatë drejtimit të përbërë mes dy periudhave të njëpasnjëshme të pushimit të përditshëm ose në mes të një periudhe të pushimit ditor dhe një pushimi javor ,ka të paktën dy shoferë në bordin e automjetit që të sigurojë ndërrime. Në orën e parë te vozitjes, prania e shoferit tjetër apo tjerëve është fakultative, por kjo është e detyrueshme për pjesën tjetër të periudhës së vozitjes;</p> <p>1.64. ”Kohëzgjatja ditore e vozitjes” është kohëzgjatja e përgjithshme e akumuluar prej mbarimit të pushimit ditor dhe fillimit të pushimit tjetër ditor ose prej mbarimit te pushimit ditor dhe fillimit te pushimit javor;</p>	<p>out any other task. It allows only the resting;</p> <p>1.62. “Daily rest time” is the part of the day during which the driver can spend the leisure time as desired and it may be a normal ‘daily rest time’ or ‘reduced daily rest time’;</p> <p>1.63. “Driving motor vehicle duration" is the driving duration by the crew, driving condition between two consecutive daily rests or between one period of daily rest and a weekly rest, when there are at least two drivers in the board of the motor vehicle in order to ensure the replacement. In the first driving hour, the presence of the other driver/drivers is facultative, but for the rest driving period it is mandatory;</p> <p>1.64. ”Daily driving duration” is the total duration accumulated since the end of the day rest and beginning of the next day rest or since the end of the day rest and beginning of the week rest;</p>	<p>obavljanya nekog drugog zadatka, kome se dozvoljava samo odmor;</p> <p>1.62. “Vreme dnevno odmor” je deo dana tokom kojeg vozač može da provede slobodno vreme prema želji i koji može da bude”dnevni odmor” ili “redukovani dnevni odmor”;</p> <p>1.63. ”Vremensko trajanje upravljanja vozila” je vremensko trajanje vožnje ekipe, stanje u kojoj u toku sastavljene vožnje između dva uzastopna perioda svakodnevnog odmora ili između jednog perioda dnevno odmora i jedan nedeljni odmor, ima najmanje dva vozača u kabini vozila kako bi obezbedili zamene. U prvom času vožnje, prisutnost drugog vozača ili drugih je fakultativno, ali toje obavezujuće za drugi deo perioda vožnje;</p> <p>1.64. ”Dnevno vremensko trajanje vožnje” je opšte akumulirano vremensko trajanje od završetka dnevno odmora i početka drugog dnevno odmora ili od završetka dnevno odmora i početka nedeljno odmora;</p>
---	--	--



<p>1.65. “Kohëzgjatja e vozitjes” është koha totale e vozitjes e regjistruar në mënyrë automatike, gjysmë automatike ose manuale në kushtet e përcaktuara në Ligj;</p> <p>1.66. “Aparat i kontrollit” nënkupton aparatën e destinuar që të jetë i instaluar brenda automjetit për të treguar dhe regjistruar në mënyrë automatike apo gjysmë automatike të dhënat mbi rrugëtimin e këtyre automjeteve dhe mbi disa, kohën e punës të ngasësve të tyre;</p> <p>1.67. “Fletë incizim” nënkupton fletën e përpiluar për të pranuar dhe shënuar incizimet, për t’i vendosur në aparatën e kontrollit dhe në të cilin mekanizmi i shtypësit (printerit) i përshkruan në vazhdimësi diagrame të të dhënave të regjistruara.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Kompetencat e Ministrisë në Sektorin e Transportit</b></p> <p>1. Ministria nëpërmjet Ministrit, përcakton politikën dhe strategjinë e zhvillimit të transportit rrugor dhe bënë rregullimin e</p>	<p>1.65. “Driving duration” is the total driving duration registered automatically, semi-automatically or manually under the conditions provided for by present Law;</p> <p>1.66. “Control device” means the device designed to be installed inside the motor vehicle in order to show and record automatically, semi-automatically or manually the data on the itinerary of these motor vehicles and in some others the working time of drivers as well;</p> <p>1.67. “Recording sheet” means the sheet designed to collect and indicate records that are to be inserted in the control device, where printer device continuously describes diagrams (charts) of the recorded data.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Competences of the Ministry in the Transport Sector</b></p> <p>1. Ministry shall, through the Minister, define the development policy and strategy of the road transport and shall regulate the transport</p>	<p>1.65. “Vremensko trajanje vožnje” je ukupno automatsko, polu- automatsko ili manualno registrovano vreme u uslovima utvrđenih Zakonom;</p> <p>1.66. “Aparat kontrole” podrazumeva namjeni aparat koji treba da bude instaliran unutar vozila koji bi pokazao i registrovao na automatski ili polu-automatski način podatke putovanju ovih vozila i nad nekima, vreme rada njihovih vozača;</p> <p>1.67. “Snimljeni list” podrazumeva sastavljen list koji prima i beleži snimanje kako bi se postavilo u aparatu kontrole u kome mehanizam šampača (printera) neprekidno opisuje dijagrame registrovanih podataka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Nadležnosti Ministarstva u Sektoru transporta</b></p> <p>1. Ministarstvo preko Ministra, utvrđuje politiku i strategiju razvoja drumskog transporta i vrši regulisanje sektora</p>
---	---	--



